



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sport

Nr: 738/2024
Datë: 08.05.2024

Duke u bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019) po ashtu duke u bazuar në Shtojcën I (një) pika tetë (8) e Rregullores (QRK) NR.14/2023 Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” me numër të protokollit 3578/2021 të datës 05.10.2021, Ushtruesi i Detyrës të Sekretarit të Përgjithshëm z. Xheladin Krasniqi, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Thirrjen Publike për Punë Praktike për Studentet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” - Fakulteti Filozofik, drejtimet Antropologji Kulturore dhe Arkeologji.

I

1. Miratohet Thirrja publike për angazhimin e trembëdhjetë (13) studentëve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti Filozofik, drejtimet Antropologji Kulturore dhe Arkeologji në punë praktike në MKRS dhe Institucionet vartëse të saj.
2. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen kriteret të cilat janë të përcaktuara në thirrjen publik të datës 08.05.2024, për Punë Praktike për Studentet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” - Fakulteti Filozofik, drejtimet Antropologji Kulturore dhe Arkeologji.
3. Mbështetja financiare publike e studenteve të angazhuar do të ofrohet nga Buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, gjegjësisht Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, kodi 815 subvencione dhe transfere në vlerë 250€ (dyqind e pesëdhjetë euro) bruto për muaj për një student, për gjithsej gjashtë (6) muaj angazhim në MKRS dhe Institucionet vartëse.

II

1. Mjetet e përmendura në nenin I pika tre (3) e këtij vendimi do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike, sipas dokumentacionit për zbatim të thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

IV

1. Në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me numër të protokollit 3578/2021 të datës 05.10.2021, si dhe Rregulloren (MKRS) Nr.09/2015 për Subvencionimin në Fushën e Kulturës, Trashëgimisë Kulturor, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të krijojë Komision Vlerësues i cili do të bëjë vlerësimin e aplikacioneve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kriteret e përcaktuara në thirrjen publike për të qenë pjesë e praktikës në MKRS apo Institucionet vartëse të saj.

V

1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të njoftojë përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
2. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Departamenti i Trashëgimisë Kulturore.

VI

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit Ligjor;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- Zyrës së Arkivit.

